

VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM

Sot më datë 17.10/2025, në selinë e shoqërisë “Marketing & Distribution” sh.p.k Kosovë, me numër fiskal 600735130 dhe numër unik 810477845, me adresë Rr. Epiri, Nr.75, Prishtinë, përfaqësuar nga Znj. Vilma NUSHI Ortaku i Vetëm i shoqërisë, vendosi mbi rendin e ditës si vijon:

1. Marrjen në shqyrtim të mundësisë së ndryshimit të emrit të shoqërisë Marketing & Distribution sh.p.k, me seli në zonën Industriale, Prishtinë, Kosovë.
2. Miratimi i Statutit të ri të shoqërisë ku do të pasqyrohet ndryshimi i mësipërm.
3. Autorizimi i personit që do të ndjek procedurën e nevojshme për të pasqyruar ndryshimet e mësipërme pranë ARBK.

Përsa i përket pikës së parë të rendit të ditës, mbështetur në interesat e shoqërisë, ortaku i vetëm ka marrë vendimin e ndryshimit të emrit të shoqërisë dhe miratimit të Statutit të ri me qëllim paqyrimin edhe në statut të këtij ndryshimi.

Përsa i përket pikës së dytë të rendit të ditës dhe përsa u diskutua dhe miratua në pikën e parë të rendit të ditës është e nevojshme të caktohet përfaqësuesi i shoqërisë që do të kryej veprimet e nevojshme për reflektimin e këtij ndryshimi në ARBK.

1. Në përfundim të mbledhjes dhe duke mos pasur asnjë pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Ortaku i Vetëm i shoqërisë, në mbështetje me Ligjislacionin për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L016, në fuqi dhe aktet e themelimit;

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e emrit të shoqërisë si më poshtë:

- Emri i shoqërisë ËSHTË:

Marketing & Distribution sh.p.k

- Emri i shoqërisë BËHET:

Marketing & Distribution Kosovë sh.p.k

2. Miratimi i Statutit të ri të shoqërisë në përputhje me Ligjislacionin Tregtar për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L016, në fuqi.
3. Caktohet Z. Ermal Ramosacaj, si përfaqësues me tagra të plota për të vepruar në emër të shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Kosovë për regjistrimin e këtij Vendimi pranë ARBK.

ORTAKU I VETËM
“Marketing & Distribution” sh.p.k
Vilma NUSHI

.....

